



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 66

Prishtinë, më 15.01.2013, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selmi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Vjollca Krasniqi dhe Danush Ademi

Munguan: Rasim Demiri dhe Ganimete Musliu

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Naim Hoxha- Këshilltar nga OSCE; Dhurata Kryeziu-OSCE; Sanije Berisha-OSCE; Naim Hajdari-EULEX; Majtaz Mravljak-EULEX; Visar Rushiti-GAP; Besnik Ramadani-KDI; Skender Perteshi-QKSS.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli, Zarife Aliu dhe Antigona Ibraj

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit të mbajtura, më 04.12.2012; 21.12.2012 dhe 26.12.2012;
3. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Komisionit për vitin 2012;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-amendamenteve për Projektligjin nr. 04/L-160 për Agjencinë e Regjistrimit Civil;

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/ L-173 për Përgjimin e Telekomunikimeve;
6. Shqyrtimi në Parim i Projektligjit nr. 04 / L-177 për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit;
7. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.

1. Miratimi i Rendit të ditës.

Kryetari i Komisionit- Filloi takimin e radhës së Komisionit, me miratimin e Rendit të Ditës, dhe kërkoi nga anëtarët nëse pajtohen me këtë rend dite.

Goran Marinković- Tha se pajtohet me pikat e rendit të ditës, por propozoi që të shtohet edhe një pikë, kjo për shkak të ngjarjeve që kanë ndodhur në Kosovë. Prandaj në pikën të ndryshme, të jetë çështja e sjelljes së disa zyrtarëve policor ndaj të burgosurve nga komuniteti serb, që kishin ardhur për vizitë në Kosovë me rastin e Krishtlindjeve ortodokse. Prandaj konsideroi se Komisioni do të realizonte funksionin që ka, të mbikëqyr institucionet sigurisë.

Kryetari i Komisionit- Kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse janë për të futur në rend të ditës pikën e propozuar nga z. Marinković.

Rexhep Selimi- Tha se me që Komisioni nuk i ka informacionet e mjaftueshme, kjo çështje mund të diskutohet në një mbledhjen e radhës së Komisionit.

Fatmir Xhelili- Për propozimin e z. Marinković tha se, për të gjitha kërkesat apo dyshimet që ekzistojnë se mund të jetë keqpërdorur forca nga ana e zyrtarëve të Policisë së Kosovës është Inspektorati Policor i Kosovës i cili merret me këto raste, prandaj konsideroi se nuk është e arsyeshme që kjo çështje të jetë e diskutueshme në shumicën e takimeve të Komisionit. Tutje shtoi se nga media është informuar se IPK-ja është duke zhvilluar hetime për këto raste, dhe në rast se konstatohet keqpërdorimi i forcës ndërmerren sanksione që parashikohen me ligj.

Kryetari i Komisionit- Tha se për këtë çështje mund të kërkohet informatë dhe më pas mund të reagoj Komisioni, gjithashtu shtoi se për këtë rast janë duke u bërë hetime nga ana e EULEX-it dhe IPK-së.

Goran Marinković- Tha se nuk pajtohet që në Komision janë trajtuar rastet e përdorimit të mundshëm të dhunës nga ana e zyrtarëve policor, por për reputacionin e policisë e cila në mënyrë të vazhdueshme ka bërë disa veprime ndaj komunitetit serb. Gjithashtu përmendi rastin, kur nga z. Rexhep Selimi është kërkuar që në rend të ditës të hyjë vlerësimi i situatës gjatë protestave të Lëvizjes Vetëvendosje, të cilën e ka mbështetur, ku nga ai është thënë se është mbrojtur rendi kushtetues me veprimet e policisë.

Me që nuk mund të jetë në këtë mbledhje rend dite pika e propozuar, kërkoi që në Komision të raportojnë Ministri i MPB-së, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë si dhe Kryeshefi i IPK-së.

Tutje tha se nga deklarata e një të burgosuri, është thënë që urdhrin për arrestim e ka dhënë z. Bojan Stovanovič, Kryetar i Komunës së Graçanicës, gjë që nuk është e vërtetë. Prandaj konsideroi se ky informacion mund të ketë dalë nga MPB-ja, ose Policia e Kosovës dhe se për këtë gjë duhet zhvilluar hetime. Për këtë arsye kërkoi që të ketë një mbledhje të jashtëzakonshme, në mënyrë që veprimet individuale të ndalen

Tutje përmendi faktin se ka informacione që me rastin e rrënimit të gjashtëdhjetë përmendoreve në varrezat serbe në Fushë Kosovë, ku policia e ka neglizhuar rastin për të mos dal në opinion, prandaj konsideroi se në këtë rast shkelen drejtat e njeriut dhe nuk realizohet bashkëjetesa mes komuniteteve.

Kryetari i Komisionit- Tha se në emër të Komisionit mund të kërkohet informatë nga ana e IPK-së, gjithashtu do të ftohet Kryeshefi i IPK-së për raportim vjetor në Komision, prandaj konsideroi se në bazë të informatës zyrtarë mund të veprohet dhe kjo çështje mund të hyj në rend të ditës.

Kryetari i Komisionit- Tha se pas informatës që do të kërkohet nga IPK-ja, do të bëhet vlerësimi për këtë çështje.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit të mbajtura, më 04.12.2012;21.12.2012 dhe 26.12.2012.

Kryetari i Komisionit- Konstatoi miratimin e Procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, të mbajtura më 04.12.2012; 21.12.2012 dhe 26.12.2012, të cilët u miratuan pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Komisionit për vitin 2012.

Kryetari i Komisionit- Për raportin e punës së Komisionit për vitin 2012, kërkoi nga anëtarët nëse kanë ndonjë vërejtje.

Fatmir Xhelili- Tha se raporti i punës i Komisionit për vitin 2012, është përshkrues dhe i përfshinë të gjitha aktivitetet e Komisionit prandaj propozoi që në këtë formë të aprovohet.

Vjollca Krasniqi- Në bazë të objektivave të përcaktuara për punën e Komisionit, raporti përfshinë të gjitha këto, prandaj përkrah miratimin e raportit të punës së Komisionit për vitin 2012.

Kryetari i Komisionit- Pas vlerësimit nga anëtarët për raportin e punës së Komisionit, hapi votimin për miratimin e tij.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me vota unanime, nxori këtë

PËRFUNDIM

Miratohet Raporti i punës së Komisionit Për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, për vitin 2012.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-amendamenteve për Projektligjin nr. 04/L-160 për Agjencinë e Regjistrimit Civil.

Kryetari i Komisionit- Fjalën ia kaloi z. Anton Quni, kryesues i grupit punues për Projektligjin për Agjencinë e Regjistrimit Civil.

Anton Quni- Tha se në takimin e kaluar janë paraqitur rekomandimet e grupit punues për Projektligjin për Agjencinë e Regjistrimit Civil, ku gjithsej janë katërmëdhjetë amendamente. Ka mbetur të diskutohet vetëm vërejtja e bërë nga ana e z. Fatmir Xhelili, që i referohet nenit 12, paragrafi 1.

Ky nen është ri formuluar si në vijim: “Buxheti i Agjencisë është vijë buxhetore e veçantë në kuadër të buxhetit të Ministrisë, të miratuar në pajtim me ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë”.

Fatmir Xhelili- Referuar nenit 12, paragrafi, 1, tha se ka vërejtje vetëm për fjalën “e veçantë”, pasi vijat buxhetore për investime kapitale, mallra, shërbime dhe paga, planifikohet prej Kryeshefit të Agjencionit të cilat më pas miratohen nga Ministri.

Ndërsa nëse i referohemi si “e veçantë”, do të duhej krijimi i një sistemi të prokurimit të veçantë dhe sektori financiar të veçantë, pasi nëse e lejmë këtë fjali do të duhej që Ministria të krijonte dy sisteme financiare. Ndërsa të gjitha amendamentet e propozuara për Projektligjin për Agjencinë e Regjistrimit Civil i përkrah.

Kryetari i Komisionit- Pas vlerësimeve të dhëna nga anëtarët për raportin me amendamente për Projektligjin për Agjencinë e Regjistrimit Civil, konsideroi se duhet miratimi i tyre.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me vota unanime nxori këtë

Përfundim

Miratohet raporti me Amendamente për Projektligjin Nr.04-L-160 për Agjencinë e Regjistrimit Civil.

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/ L-173 për Përgjimin e Telekomunikimeve.

Kryetari i Komisionit- Propozoi që, si për çdo ligj tjetër të formohet grupi punues i cili analizon projektligjin, i cili të përgatis rekomandimet për Komision, pastaj procedimin e tij në seancë. Për këtë qëllim, kërkoi nga anëtarët nëse janë dakord për themelimin e grupit punues për Projektligjin për Përgjimin e Telekomunikimeve.

Rexhep Selimi- Nga natyra e projektligjit për përgjimet dhe rëndësinë e tij, tha se duhet një përkushtim nga ana e Komisionit. Gjithashtu tha se mbështet propozimin e kryetarit për formimin e grupit punues për analizimin e këtij projektligji, ndërsa në fund të kësaj procedura pret që nga Komisioni ky projektligj t'i kthehet Qeverisë, duke pritur analiza objektive nga grupi punues.

Kryetari i Komisionit- Tha se prandaj e vlerësoi të arsyeshme formimin e grupit punues, që më pas të procedohet tutje, duke dhënë rekomandimet nga ana e Komisionit.

Anton Quni- Për projektligjin për përgjimet, tha se e autorizon Agjencinë e Kosovës për Inteligjencës, për planifikimin dhe kontrollin e përgjimeve dhe telekomunikimeve. Marrë parasysh faktin që Komisioni nuk mund të ushtroj kontrollin parlamentar ndaj tij, e konsideroi si paradoks që të merret Komisioni me shqyrtimin e ti, pasi është Komisioni për Mbikëqyrjen e AKI-së, ai i cili do duhet të merret me të.

Gjithashtu theksoi se mungesa e certifikatës së sigurisë nga ana e anëtarëve të Komisionit për Mbikëqyrjen e AKI-së, bën që ata të mos e kenë mundësinë e mbikëqyrjes së plotë ndaj AKI-së. Duhet të dihet nëse ligji në fjalë përmbush standardet evropiane, marrë parasysh rolin kryesor të AKI-së për përgjime në bazë të projektligjit të propozuar, prandaj vlerësoi se ky projektligj nuk e merr miratimin e tij.

Vjollca Krasniqi- Për projektligjin për përgjimet dhe mënyrës së përshpejtuar të ardhur në Komision, kjo e ndikuar nga disa situata siç ishin përgjimet e disa zyrtarëve të lartë në pushtet.

Ky projektligj parasheh që qendra e përgjimeve të vendoset në AKI, dhe se ky institucion nuk është organ ekzekutiv për ta kryer këtë funksion. Në këtë pikë iu referua Kodit të procedurës penale, i cili përcakton proceduar për përgjimin, prandaj konsideroi se ka një anashkalim të prokurorisë dhe gjyqësisë.

Prandaj vlerësoi se do të ishte e nevojshme që Ministri i Drejtësisë të sqaronte se cila është arsyeja që ky projektligj është përpiluar si i tillë, për këtë arsye propozoi që bazuar në përmbajtjen e këtij projektligji nuk është për formimin e grupit punues për shqyrtimin e tij, duke propozuar që ky projektligj ti kthehet Qeverisë duke mos e kaluar as leximin e parë në Komision.

Fatmir Xhelili- Për projektligjin për përgjimet tha se, nuk e sheh kaq konfuze këtë çështje duke propozuar formimin e grupit punues që do të shqyrtonte projektligjin, ku në përbërje të këtij grupi të ishin edhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Dy element janë të rëndësishëm për këtë fushe për shumë shtete, ku të bëhet vendosja e aparaturave dhe cilat struktura të shtetit të jenë përgjegjëse për aparaturat e përgjimit. Tutje shtoi që e rëndësishme është vendosja e këtyre aparaturave dhe përgjegjësia në ruajtjen e të dhënave që do të bazohej në rregulloret që dalin nga ligji.

E rëndësishme gjithashtu është të bëhet diferencimi i përgjimeve strategjike nga ato hetimore për të cilat autorizohet Policia e Kosovës bazuar në Kodin e Procedurës Penale, prandaj vlerësoi se diferencimi i këtyre elementeve të propozuara do të kontribuonte në nxjerrjen e një ligji të mirë, dhe se nuk konsideron se ka mangësi në këtë projektligj.

Prandaj propozoi formimin e grupit punues me një përbërje më të gjerë, nga anëtarët e komisionit, përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile që merren më këtë çështje.

Rexhep Selimi- Për projektligjin për përgjimet, tha se nëse procedurat do të lejonin që në këtë takim të votonte kundër këtij projektligji këtë do ta bënte, por në bazë të proceduarve një gjë e tillë do të vendoset në seancë, prandaj grupi punues që do të formohej për këtë projektligj të njëjtën gjë do të rekomandonte, që ky projektligj t'i kthehet Qeverisë, prandaj konsideroi se Komision do të vendoste në themelimin e grupit punues, procedimin tutje të këtij projektligji, duke mos bërë plotësime apo ndryshime, pasi nuk i plotëson kriteret për një shoqëri demokratike.

Goran Marinković- Tha se pajtohet me z. Selimi.

Fatmir Xhelili- Tha se nuk e konsideron zgjidhje kthimin e këtij projektligji pa u shqyrtuar nga ana e Komisionit dhe pa identifikimin e elementeve që do duhej të plotësoheshin, prandaj konsideroi se grupi punues i propozuar me një përbërje të gjerë do të kontribuonte në këtë drejtim.

Kryetari i Komisionit- Duke qenë se secili nga anëtarët ka pikëpamje individuale për këtë projektligj, propozoi që të vazhdohet me procedurë të rregullt si për çdo projektligj, në formimin e grupit punues i cili do të paraqiste rekomandimet Komisionit dhe të njëjtat do të përcilleshin në seancë.

Gjithashtu theksoi që me që ky projektligj mbulon sferën e sigurisë, kjo është arsyeja që është në Komision dhe se mund të bashkëpunoj me anëtarët e Komisionit për Mbikëqyrjen e AKI-së, duke shprehur gatishmërinë që mund të jetë edhe kryesues i grupit punues për këtë projektligj.

Rexhep Selimi- Tha se pajtohet që ky grup punues të udhëhiqet nga Kryetari, duke vlerësuar se në takimet e radhës së Komisionit mund të jepen rekomandime, duke lënë hapësirë për të diskutuar këtë projektligj nga grupi punues, duke dal me rekomandime për të kthyer ose jo këtë projektligj.

Gjithashtu e vlerësoi si të nevojshme që në grupin punues të përfshihen edhe anëtarët e Komisionit për AKI, duke theksuar që pret që ky ligj t'i kthehet Qeverisë, pasi në formën që është paraqitur nuk i përmbush standardet e një shoqërie demokratike.

Kryetari i Komisionit- Duke iu referuar proceduarve për procedimin tutje të projektligjit, citoi nenin 56 të Rregullores së Kuvendit, pikën 2, *“para shqyrtimit të parë të projektligjit në mbledhjen plenare, Komisionin funksional dhe raportues i ngarkuar nga Kryesia e Kuvendit e shqyrton projektligjin në parim, Komisioni i paraqet Kuvendit raport me rekomandime për miratim ose për mos miratim të ligjit në parim”*.

Prandaj e konsideroi të arsyeshme formimin e grupit punues për projektligjin për përgjimet, i cili do të bënte raporti me rekomandime dhe më pas paraqitjen e tyre në seance, ku dhe do të merrte miratimin ose jo për tu proceduar tutje ky projektligj.

Vjollca Krasniqi- Sugjeroi që, me që për projektligjin për përgjimet vendimet për përgjime duhet të bazohen në Kodin e Procedurës Penale, propozoi që ky projektligj të kalonte edhe në Komisionin për Legjislacion, i cili është më kompetent për interpretimin e këtij Kodi.

Kryetari i Komisionit- Tha se, ky projektligj i është drejtuar për shqyrtim Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të AKI-së dhe se në Komisionin për Legjislacion të gjitha projektligjet kalojnë, pasi kjo është e përcaktuar me rregullore.

Fatmir Xhelili- Propozoi që të vazhdohet me procedurat e formimit të grupit punues dhe më pas nxjerrjen e rekomandimeve të cilat do ti paraqiteshin në seancë. Tutje propozoi Kryetarin, për kryesues të grupit punues.

Kryetari i Komisionit- Ftoi anëtarët që të japin propozimet për formimin e grupit punues për projektligjin për përgjimet.

Në këtë pikë të rendit të ditës, Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me vota unanime morri këtë

VENDIM

Formohet Grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit Nr. 04/L-173 për përgjimin e telekomunikimeve. Grupi punues ka këtë përbërje: Ahmet Isufi-raportues, Fatmir Xhelili, Rexhep Selimi dhe Anton Quni, anëtarë

6. Shqyrtimi në Parim i Projektligjit nr. 04 / L-177 për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit.

Kryetari i Komisionit- Për projektligjin për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit, tha se mund të vazhdohet me procedurat për formimin e grupit punues për shqyrtimin e këtij projektligji, dhe ftoi anëtarët që të japin propozimet për grupin punues.

Në këtë pikë të rendit të ditës, Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me vota unanime morri këtë

VENDIM

Formohet Grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit Nr. 04/L-177 për dërgimin e Forcës së sigurisë së Kosovës jashtë vendit. Grupi punues ka këtë përbërje: Anton Quni-raportues, Fatmir Xhelili, Rexhep Selimi dhe Goran Marinković, anëtarë

7. Të ndryshme

Goran Marinković- Në këtë pikë përsëri ngriti çështje e arrestimit të disa pjesëtarëve të komunitetit serb, me rastin vizitës në Kosovë. Gjithashtu shprehi keqardhjen që kërkesa e bërë për të shtuar një pikë të rendit të ditës nuk u përkrah nga anëtarët e Komisionit, duke vlerësuar se më këtë gjë janë mbrojtur disa persona që nuk ia donë të mirën vendit. Tutje tha se me mos trajtimin e çështjes së propozuar nga ana e tij, Komisioni nuk e realizoi funksionin që ka, të mbikëqyr institucionet e sigurisë, duke theksuar që në Komision ka qenë konstruktiv për çdo situatë.

Kryetari i Komisionit- Tha se nga Inspektorati Policor i Kosovës, do të kërkohet informatë, dhe në bazë të informacioneve të pranuara do të diskutohet për këtë çështje.

Anton Quni- Tha se edhe nga takimi i kaluar, ka propozuar formimin e grupit punues i cili do të shqyrtonte procesin e gradimeve për gradën e Nënkolonelit në Policinë e Kosovës, për të cilën gjë duhet të njoftohen edhe autoritete përkatëse, në mënyrë që të kemi informacione për këtë proces. Gjithashtu propozoi që pas skandaleve të njëpasnjëshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme, të bëhet kërkesë nga ana e Komisionit që në një të ardhme më afërt, Ministri të ftohet për interpelancë në Kuvend për të ju përgjigjur pyetjeve të deputetëve në lidhje me skandalet që kanë ndodhur në këtë institucion.

Kryetari i Komisionit- Tha se për grupin punues për shqyrtimin e procesit të gradimeve në Policinë e Kosovës, është rënë dakord që të formohen që nga takimi i kaluar, dhe se në një nga mbledhjet e radhës mund të formohet. Ndërsa për kërkesën që të ftohet Ministri i MPB-së, për raportim, tha se në Komision mund të ftohet kurdo që vlerësohet e nevojshme nga anëtarët e Komisionit, ndërsa për interpelancë në Kuvend duhet nënshkrimi i një numri të deputetëve.

Rexhep Selimi- Konsideroi se debatet publike në Komision, siç ka qenë rasti kur është ftuar Ministri i MPB-së, jo gjithmonë kanë qenë produktive, ndërsa nëse do të ishte në interpelancë parlamentare, kjo do të shërbente demokracisë në vend, duke shtuar se do ta mbështeste një gjë të tillë, duke kërkuar që edhe në këtë rast Komisioni të reflektonte objektivisht.

Gjithashtu duke iu referuar asaj se çfarë tha z. Marinkovič, tha se në bazë të procedurave do të kërkohet raport nga Inspektorati Policor i Kosovës dhe më pas analizimin e tij, duke shtuar se nuk mbështetën shkelësit e ligjit.

Kryetari i Komisionit- Për propozimet që u dhanë në këtë takim, formimi i grupit punues për shqyrtimin e gradimeve për gradën e Nënkolonelit në Policinë e Kosovës dhe interpelancës në Kuvend për Ministrin e MPB-së, ftoi anëtarë që në takimin e radhës së Komisionit të përgatitet për këto çështje, në mënyrë që të ushtrohet kontrolli demokratik ndaj këtyre institucioneve.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi